



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
“TEDA TIRANË” SH.P.K.

V E N D I M

Nr. 5, datë 03 / 11 / 2025

PËR

“MIRATIMIN E ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË “TEDA TIRANË”
SH.P.K.

DHE

MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË ZËRAVE BUXHETORË TË PROJEKT-
BUXHETIT PËR VITIN 2025”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar; Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Vendimit Nr. 169, datë 20.03.2024, të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Kontratës, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Zhvilluesit, Bashkia Tiranë, për Ndërtimin, Administrimin dhe Monitorimin e Funkcionimit të Zonës së Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik në Tiranë (TEDA Tiranë)”; Vendimit Nr. 54, datë 30.05.2024, të Këshillit Bashkiak, “Për Krijimin e shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në Pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e Akteve të Themelimit”; Vendimit Nr. 1, datë 21.02.2025, të Asamblesë së Përgjithshme, “Për miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2025, të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k.”, Vendimit Nr. 2, datë 21.02.2025, të Asamblesë së Përgjithshme “Për miratimin e rregullores së brendshme të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k.” dhe Vendimit Nr. 56, datë 24.07.2025, të Këshillit Bashkiak “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”

Sot, më datë 3 / 11 / 2025, ora 11 : 00, u mbledh Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., me NIPT M41824035Q, pranë selisë qendrore të Ortakut Themelor me adresë: Sheshi “Skënderbej”, Ndërtesa 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri, me prezencën e 100% të kuotave pjesëmarrëse, respektivisht të Ortakut të Vetëm themelues i shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., **Bashkia Tiranë**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Në Mungesë dhe me Urdhër, Nën Kryetarja e Bashkisë Tiranë, Znj. Anuela RISTANI dhe shoqëria “**TEDA Tiranë**” sh.p.k., përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë, Z. Dritan DELIJA, me rendin e ditës si më poshtë vijon:

Rendi i ditës:

1. Për miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., me anë të kontributit në para nga ortakët i vetëm, Bashkia Tiranë, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 56, datë 24.07.2025, “Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
2. Për Miratimin e ndryshimit të Nenit 6, pika 3, të statutit të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 24.07.2025, “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
3. Për miratimin e Aneksit 2, të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me Seli në Tiranë “TEDA Tiranë” sh.p.k.
4. Për Miratimin e rialokimit të zërave buxhetorë, pas zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 24.07.2025, “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”.

Në lidhje me pikat e rendit të ditës, Ortaku i Vetëm **Vendosi**:

1. Për miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., nëpërmjet kontributit në para nga ortakët i vetëm themelues Bashkia Tiranë, në bazë të Vendimit Nr. 56, datë 24.07.2025, të Këshillit Bashkiak, “Për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”, në shumën prej **35,528,733** (tridhjetë e pesë milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë, duke e rritur kapitalin e kësaj shoqërie në vlerën e përgjithshme **55,528,833** (pesëdhjetë e pesë milionë, e pesëqind e njëzet e tetë mijë, e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë.
2. Për Miratimin e ndryshimit të Nenit 6, pika 3, të statutit të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 24.07.2025, “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”. Në përputhje me parashikimin e Nenit 13 të Statutit të shoqërisë, Neni 6, pika e tretë, ndryshon dhe bëhet si më poshtë vijon:

Neni 6

Kapitali i TEDA Tiranë

- Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon ortakëve dokumentin vërtetues për sasinë e shumave të derdhura në fazën e themelimit
- Kapitali themeltar i shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k. përbëhet nga kontributi në para nga Ortaku themelues.

- Kontributi në para do të ketë vlerën prej 55,528,833 (pesëdhjetë e pesë milionë, e pesëqind e njëzet e tetë mijë, e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë, e zotëruar nga Ortaku i vetëm.

3. Për miratimin e Aneksit 2, të Statutit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar me Seli në Tiranë “TEDA Tiranë” sh.p.k.
4. Për Miratimin e rishikimit të zërave buxhetorë, pas zmadhimit të kapitalit të shoqërisë me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 56, datë 24.07.2025, “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”.
5. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për ndjekjen e procedurave të regjistrimit të ndryshimit të kapitalit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

ORTAKU THEMELUES:

BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga:

KRYETARI

ERION VELIAJ

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Anueta RISTANI



ANEKS 2
Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
me Seli në Tiranë
“TEDA TIRANË”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Referuar Nenit 81, paragrafi 1, pika b, parashikohet shprehimisht: “Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme: b) ndryshimet e statutit”, si dhe parashikimit të Nenit 16 të Statutit të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 54, datë 30.05.2024, “Për krijimin e shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë dhe miratimin e Akteve të Themelimit”; Vendimit Nr. 1, datë 21.02.2025, të Asamblesë së Përgjithshme, “Per miratimin e projekt-buxhetit për vitin 2025, të shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k.”, Vendimit Nr. 56, datë 24.07.2025, të Këshillit Bashkiak “Për zmadhimin e kapitalit për shoqërinë “TEDA Tiranë” sh.p.k., si person juridik në pronësi të Bashkisë Tiranë”

Neni 6
Kapitali i TEDA Tiranë

1. Kapitali fillestar i investuar nga ortakët, përbën bazën e krijimit të fondit themeltar të mjeteve të xhiros. Administratori i dorëzon ortakëve dokumentin vërtetues për sasinë e shumave të derdhura në fazën e themelimit
2. Kapitali themeltar i shoqërisë “TEDA Tiranë” sh.p.k. përbëhet nga kontributi në para nga Ortaku themelues.
3. Kontributi në para do të ketë vlerën prej 55,528,833 (pesëdhjetë e pesë milionë, e pesëqind e njëzet e tetë mijë, e tetëqind e tridhjetë e tre) Lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë, e zotëruar nga Ortaku i vetëm.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

ORTAKU THEMELUES:

BASHKIA TIRANË

Përfaqësuar nga:

KRYETARI

ERION VELIAJ

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Anueta RISTANI